

KËRKESË
Nr. 5676, datë 12.9.2019
PËR SHPALLJEN E 1 VENDI VAKANT PËR POZICIONIN “SPECIALIST PËR
ZBARDHJEN DHE REDAKTIMIN E VENDIMEVE” NË KËTË INSTITUCION

Në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Specialistit për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: IV-a

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- a) Të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë në degën gjuhë-letërsi.
- b) Të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c) Të kenë të paktën tre vite përvojë pune në profesion.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.
- Ndaj tyre të mos jetë nisur procedim penal, të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundravajtje penale.
- Ndaj tyre të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;
2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.
3. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (origjinale ose të noterizuar).
4. Dëshmi penaliteti.
5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda 15 ditëve pas publikimit të njoftimit pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna-premte ora 8:30-17:00, ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.